



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE

Nr. 445 prot.

Tiranë, më 23/02/2024

Lënda: Realizimi i detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TIRANË

Në mbështetje të pikës 6, gërma c, të VKM nr. 325 datë 18.05.2022 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë", Ju përcjellim realizimin e detyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, për periudhën janar-dhjetor 2023.

Objektivi nr.1. Përmirësimi i paketës ligjore në fushën e metrologjisë për përafrimin me legjislacionin Evropian

DPM nepermjet dy perfaqesuesve te saj ka siguruar pjesmarrjen në Takimin e Prezantimit Dypalësh me shërbimet e BE për kapitullin 1 "Lëvizja e lirë e mallrave" që u zhvillua në datat 30 janar - 2 shkurt 2023 në Bruksel, sipas Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPM-së nr. 19, datë 26.01.2023. Perfaqesuesit e DPM-se (znj. Piluri dhe znj. Senka) për një periudhë dy mujore përpara takimit final pregatiti një grup dokumentesh, ndër të cilët përmëndim:

- Dokumentin "Guiding Questionnaire" kap.1 "Levizja e lire e mallrave",
- Dokumentinekomponentit te "antikorrupsionit".
- Dokumentin e mekanizimit te "accelerated integration",
- Prezantimet për 5 direktiva, përkatësisht për instrumentet mates (direktiva 2014/32/EU, MID), instrumentet matës të peshimit jo-automatik (direktiva 2014/31/EU, NAWI), njësitë matëse (direktiva 2009/3/EC që ka amenduar direktivën 80/181/EEC e amenduar nga direktivat 85/1 EEC, direktiva 89/617/EEC, direktiva 1999/103/EC, direktiva 2019/1258/EC), parapaketimet (direktiva 2007/45/EC dhe direktiva 76/211/EEC) dhe shishet enëmatëse (direktiva 75/107/EEC).

Gjithashtu, u mor pjesë në dy takime:

- 23 janar 2023 sipas formatit takim "Mocking Exercise 2" per kap.1, me mbështetje të ekspertëve GIZ SANECA.
- 26 janar 2023, takim përgatitor me Ministrin e Shtetit, kryenegociatoren M. Dhuka, përpara takimit bilateral për Kapitullin 1, në Kryeministri.

- Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2023, në cilësinë e anëtareve të grupit të punës, punonjësit e DPM-se kanë dhënë kontribut për hartimin e startegjisë ndërsektoriale për mbrojtjen e konsumatorit për periudhën 2023-2030.

- Gjatë vitit 2023 është siguruar pjesëmarrje në grup pune lidhur me mundësinë e rishikimit të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", në zbatim të urdhërit të Ministrit të MFE-së nr.12, datë 18.01.2023 "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e rishikimit të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", në kuadër të rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH).

- Gjatë vitit 2023 nuk është miratuar asnjë nga urdhërat e ministrit përgjegjës për metrologjinë, të cilët janë në proces miratimi, konkretisht: Urdhëri "Për miratimin e tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar" dhe Udhëzimi "Për përshkrimin e shenjës dalluese "instrument matës jo në përdorim" të instrumenteve matëse që janë në vendin e përdorimit, por nuk janë verifikuar sipas procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë". Në kuadër të ketij objektivit, nga DML janë përgatitur dhe janë miratuar urdherat e brendshëm, konkretisht:

- Urdhëri i DP nr.14, datë 24.01.2023 "Për përcaktimin e tipit, formës dhe fiksimit e shenjave të përdorura për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit", Rregullorja nr.1, datë 24.01.2023 "Për përcaktimin e tipit, formës dhe fiksimit e shenjave të përdorura për verifikimin e instrumentave matës ligjërisht të kontrolluara, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së verifikimit";
- Urdhëri i DP nr.42, datë 23.02.2023 "Për përcaktimin e afateve dhe procedurave për dhënien e informacionit për instrumentet matëse të verifikuara";

Objektivi nr.2. Përmirësimi i treguesve teknik dhe financiar për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit nga matjet e pasakta

- Sipas planeve të punës të miratuara për planet e sektorëve të shërbimeve, numri i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara të planifikuara për t'u verifikuar ishte 39 100 dhe janë verifikuar 40 000 instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara të planifikuara, me realizim 102%; ndërsa treguesi i të ardhurave ishte planifikuar në masën e 51 261 000 lekë, por janë realizuar 56 368 440 të ardhura (pa TVSH), me realizim 110%.

- Nga laboratorët kalibruar:

Totali i kalibrimeve DMSHI, janar - dhjetor 2023:	= 2352 instrumente
Totali i kalibrimeve DMSHI, janar - dhjetor 2023 (të jashtme)	= 1331 instrumente
Totali i kalibrimeve DMSHI, janar - dhjetor 2023 (të brendshme)	= 1021 instrumente
Totali i të ardhurave DMSHI, janar - dhjetor 2023	= 17 237 308 leke (pa tvsh)

- Gjatë vitit 2023 janë nxjerrë 11 (njëmbëdhjetë) vendime administrative, nga të cilët janë 5 për ri-autorizime, 4 për ndryshim autorizimi dhe 2 për revokim autorizimi.

Referuar Urdhërit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 149, datë 19.05.2022, personave juridike dhe fizike që janë autorizuar sipas vendimeve perkatëse administrative nga DPM ju kryhen monitorime të vazhdueshme të performancës së tyre.

Konkretisht, në zbatim të planit vjetor për kryerjen e vizitave monitoruese në subjektet e autorizuar nga DPM, dokumentuar përmes Memo-s Nr.88 prot, datë 13.01.2023 "Mbi miratimin e planit vjetor për kryerjen e vizitave monitoruese, për vitin 2023, në subjektet e autorizuar nga DPM", si dhe shkresës me Nr.88/1 prot, datë 13.01.2023 "Plani vjetor për kryerjen e vizitave monitoruese

për vitin 2023, në subjektet e autorizuar nga DPM”, gjatë vitit 2023 janë kryer 16 (dhjetë) vizita monitoruese në subjektet e autorizuar nga DPM.

Objektivi nr.3 Mirëmbajtja e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë sipas ISO 17025 dhe CIPM MRA, Zgjerimi i SMC në laboratore/fusha të tjera, në përputhje me prioritetet/planin e veprimit të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale. Implementimi i kërkesave të standardit ISO/IEC 17020: 2012 “Vlerësimi i konformitetit; Kërkesat për funksionimin e llojeve të ndryshme të organeve që kryejnë inspektim” në sektorët e shërbimit të Drejtorisë së Metrologjisë Ligjore

Gjate vitit 2023 është evidentuar nevoja e rishikimit të një pjese të konsiderueshme të procedurave standarde operacionale të dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit në përputhje me Politikën e Cilësisë, konkretisht 7 procedura operacionale sipas ISO 17025:2017.

Krahas dokumentacionit horizontal të Sistemit të Menaxhimit, Sektori i Sigurimit të Cilësisë në DSCP ka rishikuar procedurat teknike që janë hartuar apo rishikuar nga sektorët/laboratorëte DMSHI, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 17025:2017, si dhe në përputhje me prioritetet e planit vjetor 2023 të Drejtorisë së Metrologjisë Shkencore dhe Industriale, konkretisht 2 procedura teknike.

Në funksion të përmbushjes së kërkesave të SMC, u hartua Raporti vjetor i rishikimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë i cili, u diskutua dhe miratua në mbledhjen vjetore mbajtur me datë 18.02.2023. Ky raport është hartuar mbështetur në procedurën operacionale DPM-PO-07 version 07 datë 04.10.2023. “Për rishikimin e Sistemit të Menaxhimit”. Bazuar në diskutimet, vendimet dhe konkluzionet e kësaj mbledhje u hartuan minutat përkatëse që përfshijnë dhe planin e veprimit.

Grupi i Menaxhimit të Rrishtit i ngritur me Urdhërin nr. 9 datë 04.01.2019, ka rishikuar statusin e veprimeve të ndërmarra me qëllim eliminimin apo minimizimin e rrishteve bazuar në metodologjinë e përshkruar në procedurën operacionale DPM-PO-23, si dhe ka plotësuar regjistrin e rrishtit & planin e trajtimit të rrishteve të cilat u prezantuan dhe miratuan në mbledhjen vjetore të rishikimit të menaxhimit dhe kanë qenë objekt rishikimi, në vartësi të aktiviteteve të ndërmarra gjatë gjithë vitit 2023.

Sektori i Sigurimit të Cilësisë në DSCP ka punuar në mënyrë sistematike për të plotësuar dhe mirëmbajtur regjistrimet e nevojshme të cilësisë dhe ato teknike, bazuar në Politikën e Cilësisë dhe procedurat e dokumentuara të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë. Këto regjistrime lidhen me personelin (kompetencën, trainimet autorizimet, programi vjetor i trainimeve) auditimet e brendëshme, pajisjet (inventari i pajisjeve, plani i mirëmbajtjes, programi i kalibrimeve për vitin 2023, regjistri i softuare dhe harduare për çdo laborator të DMSHI, programi afatgjatë i pjesmarjes në ndërkrahasime laboratorike, aftësitë matëse dhe kalibruese të laboratorëve, etj).

Gjithashtu, në përmbushje të detyrave të programuara për vitin 2023 është punuar për hartimin e dokumentacionit të Sistemit të Menaxhimit sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012, me qëllim implementimin e tyre në metrologjinë ligjore. Në lidhje me këtë objektivi janë hartuar dhe rishikuar 12 dokumente të cilat përfshijnë manual cilësie, procedura operacionale, forma dhe procedura teknike.

Është miratuar nga DML edhe procedura e verifikimit të instrumenteve të peshimit në lëvizje (WIM).

Objektivi nr. 4: Rritja e kapaciteteve teknike dhe përmirësimi i kushteve të punës

Në funksion të realizimit të këtij objekti është realizuar kalibrimi i të gjithë etaloneve të punës që përdoren nga metrologët për kryerjen e procesit të verifikimit të instrumentave matës ligjërisht të kontrolluar, konkretisht: peshoret elektronike të kapaciteteve të ndryshme, gramarë të klasave dhe kapaciteteve të ndryshëm dhe cilindra, si dhe për çdo instrument të kalibruar është lëshuar certifikata e kalibrimit.

Nuk është realizuar procedura e tenderimit për kalibrimin e instrumenteve matës të DPM-se. Gjithashtu është punuar në grup punë me AKSHI-in për ngritjen e Regjistrimit Elektronik të Metrologjisë.

Objektivi nr. 5: Rritja e kapaciteteve menaxhuese e profesionale të administratës

➤ Programe trajnimi

Për përmirësimin e njohurive dhe zhvillimin profesional të stafit verifikues të instrumenteve matës janë miratuar programe trajnimi, të cilat janë miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të DPM, konkretisht përmes MEMO-s me Nr.131 prot, datë 18.01.2023 "Mbi miratimin e programit vjetor të trajnimit të personelit të DML-së" dhe shkresës me Nr.131/1 prot, datë 18.01.2023 "Programi vjetor i trajnimit të personelit të DML-së", si dhe për punonjësve të rinj të DML-së, MEMO me Nr.132 prot, datë 18.01.2023 "Mbi miratimin e programit të trajnimit për punonjësit e rinj të DML-së", si dhe shkresës me Nr.132/1 prot, datë 18.01.2023 "Programi i trajnimit për punonjësit e rinj të DML-së". Trajnimet sipas fushave përkatëse janë zhvilluar në sektorët e shërbimeve kur janë realizuar kalibrimet e etaloneve të punës.

-Pjesëmarrja në trajnimin e detyrueshëm "Njohja me Administratën Publike" për periudhën 23 Janar - 6 shkurt 2023, nga 7 (shtatë) punonjësit, të cilët ishin në periudhë prove;

-Gjatë vitit 2023 është realizuar pjesëmarrja në 41 webinarë të organizuara nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA),

-Pjesëmarrje e punonjësve të sektorit të parapaketimeve në trajnimin online gjatë muajit gusht për standardin ISO/IEC 17065:2012 "Produkte, procese dhe shërbime certifikuese", dhe pajisja me certifikata pjesëmarrje.

Është realizuar trajnimi për standardin ISO IEC 17025:2017 në datë 26.04.2023 me menaxherin e cilësive të DPM-se fokusuar në implementimin e kërkesave në sistemin e menaxhimit të cilësive për punonjësit e DPM-se.

➤ Promovime të aktiviteteve të DPM dhe botimi i gazetës periodike Metrologjia.

-Është realizuar fushata ndergjegjëse me Dhomen e Tregtisë dhe Universitetin "Ismail Qemali" në qytetin e Vlores në datë 12-13 janar 2023 në bashkëpunim me institucionet e infrastruktures të cilësive DPS dhe DPA.

-Është realizuar fushata ndergjegjëse me studente dhe pedagoge të Universitetit të Sarandës në datën 01 Qershor 2023 në bashkëpunim me institucionet e infrastruktures të cilësive, DPS dhe DPA.

-Sesion informues në lidhje me vendosjen e shenjës (e) të konformitetit në qytetet Tiranë, Lezhë dhe Shkodër në datat 13 -15 dhjetor 2023.

-Botimi i gazetës "Metrologjia" në muajin shkurt dhe shtator.

➤ Ndryshime në personel

Gjatë vitit 2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë ka patur një numër të madh vendesh vakante në pozicionet specialist dhe përgjegjës sektori që ka arritur deri në 22 pozicione. DPM miratoi strukturën e re të saj sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.144 datë 26.09.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë”, në të cilën u reduktuan pozicionet e punës nga 103 në 98.

➤ Treguesit e DPM-së sipas llogarive deri më 31.12.2023.

Plani Vjetor	Plan 2023 Realizimi 12 Mujor	Fakt 2023
Llog. 600 (Paga)	92 245 940	91 806 304 lekë.
Llog. 601 (Sigurime)	15 447 793	15 336 211 lekë.
Log. 602 (Sh. Korente)	36 000 000	29 078 663 lekë.
Log. 605 (kuota)	3 700 000	3 686 628 lekë.
Llog. 606 (ndihma ekonom)	726 000	721 155 lekë.
Log. 602/ (Shpenzime nga ardh)	10 000 000	4 991 589 lekë.
Llog 466 (TVSH)	0	13 814 528 lekë.
Llog 231 (Invest)	8 000 000	0 lekë
TOTALI	166 119 733 lekë	159 435 078 lekë

Objektivi nr. 6 Forcimi i bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare dhe europiane të metrologjisë, dhe homologët

- Në datat 03-05 maj 2023 është marr pjesë në mbledhjen vjetore të Komitetit Teknik të WELMEC, mbajtur në Braunschweig, Gjermani.
- Pjesëmarrje online në takimin e organizuar nga IMEKO (Konfederata Ndërkombëtare e Matjeve), gjatë 8-9 Shtator 2023.
- Pjesëmarrje në takimin rajonal “EU4 Biznesi: Nxitja e tregut të përbashkët rajonal përmes infrastrukturës së cilësisë dhe E-tregtisë që u zhvillua në Budva, Mal i Zi, organizuar nga CEFTA në datat 29-30 Mars 2023, bazuar në Urdhërin e DP nr. 87, datë 23.03.2023.
- Pjesëmarrje në takimin rajonal “EU4 Biznesi: Nxitja e tregut të përbashkët rajonal përmes infrastrukturës së cilësisë dhe E-tregtisë që u zhvillua në Durrës, Shqipëri organizuar nga CEFTA në datat 06-07 Qershor 2023, për direktiven e makinerive.
- Në kuadër të projektit “Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) Albania, Forcimi i cilësisë dhe kapacitetit të pajtueshmërisë për zinxhirët e zgjedhur të vlerës” dhe aktivitetet e përbashkëta me institucionet e infrastrukturës të cilësisë janë realizuar:
 - Takim online me Institutin Zvicëran të Metrologjisë në kuadër të projektit GQSP Albania - METAS - DPM/Supporting Metrology, 28.04.2023.
 - Takim online GQSP -DPM “GAPs analyses and work plan” në datë 10 shkurt 2023 me ekspertin e UNIDO, Nigel Croft.
 - Takim në workshopin organizuar nga UNIDO/GQSP me temë “Interim stakeholders workshop” në datë 17.02.2023.

- Takim online ne date 2 maj 2023 me ekipin e UNIDO-s per prezantimin e raportit "Refuzimet kufitare në tregët kryesore globale për Shqipërinë" të përgatitur me mjetin Analiza të Pajtueshmërisë me Standardet (SCA).
- Takim i dyte i komitetit drejtues te GQSP ne ambientet e Ministrise te Bujqesise dhe Zhvillimit Rural ne date 06 qershor 2023.
- Takim i perfaqesuesit te DPM-se, znj. Erinda Piluri me Znj. Dorina Nati, menaxhere e programit GQSP ne date 8 Qershor 2023.
- Takim online ne date 18.08.2023 me perfaqesues te institutit zviceran te metrologjise (METAS) per aktivitetet ne vazhdim.
- Trajnim te specialisteve te sektorit te parapaketimeve ne DAM Bavari, Gjermani "Produktet e parapaketuara sipas OIML R79 dhe OIML R87 nga data 03-07 Korrik 2023.

Objektivi nr. 7: Bashkëpunimi me ministrinë dhe institucionet e tjera qëndrore

Referuar ketij objektivi, DPM, ne funksion te mbarevajtjes se punes ka kerkuar dhe ka pasur bashkepunim me:

- Drejtorinë e Përgjithshme e Punëve Publike, Bashkia Tiranë, për verifikimin e taksimetrave nga DML;
- "OSSH-Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" Sh.a dhe Subjektet e autorizuara për verifikim të matësave të energjisë elektrike;
- Kërkesa për informacion drejtuar bashkive të Republikës së Shqipërisë për të dhëna mbi numrin e licencave të dhëna për ushtrim aktiviteti "shërbim taksi/transport udhëtarësh 4+1/8+1";
- Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) për subjektet të cilat nuk pranojnë ose/dhe pengojnë verifikimin e instrumenteve matëse ligjërish të kontrolluara;
- Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Konfederatën e Industrive të Shqipërisë, për funksionimin e Këshillit të Metrologjisë;

Eshte nenshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) dhe Fakultetit të Shkencave të Natyrës (FSHN), Universiteti i Tiranës.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Petrit Rama

